



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.191 dt.29.09.2000

**PER BLERJE TRUALLI**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e tij të dt.29.09.2000, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës “Për blerje trualli”, dhe bazuar në ligjin Nr.7980, dt.27.07.1995, “Për shitblerjen e trojeve “, në V.K.M. Nr.312, dt.10.06.1994, “Për çmimin e truallit”, në V.K.M. Nr.165, dt.29.09.1997, “Për miratimin e rregullores për shitje trualli”, në ligjin Nr.8652, dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor”,

**V E N D O S I**

1. Të miratojë shitjen e truallit me sipërfaqe = 60m<sup>2</sup>, në rrugën “Ymer Kurti”, pranë pallatit 1/1, në favor të banorëve të pallatit me përfaqësuese Alma Teliti.
2. Të miratojë shitjen e truallit me sipërfaqe = 50m<sup>2</sup>, në rrugën “Dora D’istria” në favor të banorëve të pallatit 8/1.
3. Të miratojë shitjen e truallit me sipërfaqe = 160m<sup>2</sup>, në rrugën “Muhamet Gjollesha”, në favor të z. Pasho Këlliçi.
4. Të miratojë shitjen e truallit me sipërfaqe = 80m<sup>2</sup>, në rrugën e Durrësit, në favor të Gëzim Shllakut.
5. Nga ana financiare për të gjitha rastet e mësipërme duhet të bëhet likuidimi i qerasë së truallit sipas dispozitave në fuqi.

6. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Urbanistikës, Drejtoria e Financës dhe Drejtoria Juridike.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**